



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 583 / Prot.
3

Tiranë, më 24 / 6 / 2015

VENDIM

“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 12, datë 24 / 6 / 2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Znj. [] ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr.583 Prot., datë 10.06.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Drejtoria e Policisë së Shtetit, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/Znj. [] ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/Drejtoria e Policisë së Shtetit, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, kërkesën datë 19.05.2015, me të cilën ka kërkuar t’i vihen në dispozicion numri total për çdo muaj i hyrje daljeve të emigrantëve shqiptar në të gjitha pikat doganore, për vitet 1998 deri në 2015.

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit.

Komisioneri, pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me urdhrin nr.145, datë 15.06.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Grupi i inspektimit konstatoi se kërkesa e Znj. [] është regjistruar në protokollin e Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, strukturë vartësie e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, me nr.D-8 Prot., datë 25.05.2015.

Gjatë inspektimit u konstatua se, ndryshe nga sa pretendon ankuesi/ Znj. [], Autoriteti Publik/Drejtoria e Policisë së Shtetit e ka informuar kërkuuesin duke i kthyer përgjigje me shkresën nr.578/1 Prot., datë 08.06.2015.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 583 Prot., datë 10.06.2015 të Znj. kundër Autoritetit Publik/ Drejtoria e Policisë së Shtetit.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot në datë 24.06.2015.

Beshnik DERVISHI

KOMISIONERI